

Gruas Kosovare

përmbajtja

Marte Prenkpalaj u Shpërblye me Çmim Ndërkombëtar

- 2 Lobi Rajonal i Grave Avokojnë në Vjenë
- 2 Bluza e RrGK Shëtiti rreth Evropës
- 2 Shënime nga Takimi i Nëntorit
- 3 Gratë Prezantohen në Ditët e Trashëgimis Kulturore
- 3 Gratë Prezantuan Punëdoret në Panair
- 3 Shënime nga Takimi i Shtatorit
- 4 Fondi Global për Gratë Takohet me RrGK
- 4 RrGK Ndanë Përvojat në Takimin në Spanjë

njohtimet

Kuvendi Vjetor i RrGK.....
.....**Hani i Dy Roberteve**
.....**Prishtinë, 10:30**
.....**9 Dhjetor**

**RrGK Ju Uron
Me Fat
Festat e Fundvitit!!!**

**RRJETI I GRUPEVE TË
GRAVE TË KOSOVËS**



**KOSOVA WOMENS
NETWORK**

www.womensnetwork.org

Marte Prenkpalaj, aktiviste e grave nga Has, së bashku me 13 të lauruara tjera nga gjithë bota, fitoi Çmimin për Kreativitetin e Grave në Jetën Rurale 2006 nga Women's World Summit Foundation's (WWSF). RrGK i'a dorëzoi këtë çmim gjatë ceremonisë të mbajtur me 15 tetor në Hotelin Grand në Prishtinë. Artistë të njohur performuan këngë dhe monologje dhe disa nga politikanët folën për të arriturat e Martës, si dhe ishin të pranishëm shumë qytetar nga Prishtina, rajoni i Hasit dhe Krusha e Vogël për ta nderuar atë. Marta ka lindur në një fshat të vogël të Zymit, që është i vendosur në rajonin e Hasit. Si një vajzë fshatare, viteve të 70-a, Marta luftoi për të drejtën për arsimim. Atëherë nuk kishte asnjë shkollë të mesme në Has, dhe studentët duhet të ecnin dy orë për të arritur në shkollë dhe dy orë për tu kthyer, rrugëtim ky që vajzat nuk lejoheshin ta ndërmermin. Pas një angazhimi, Marta arriti të bindë familjen e vet që ta lejë të vazhdojë shkollimin.

Ajo përfundon shkollën e mesme dhe vazhdon mësimet për të fituar diplomën në Biologjisë dhe Kimisë. Në vitin 1990, ajo u përfshi në një fushatë që luftonte analfabetizmin e grave. E fuqizuar nga kjo përvojë dhe e motivuar nga ndryshimet që pa në komunitetin e saj, ajo u aktivizua në krijimin e Shoqatës për Arsimimin e Grave 'Motrat Qiriazit' në vitin 1995 së bashku me Safete dhe Igballe Rogovën.

Në vitin 1995, ajo gjithashtu u bë drejtoresha e parë e një shkolle në rajonin e Prizrenit. Duke e ditur sa vështirë e kishte pasur gjatë shkollimit të saj, Marta punonte me komunitetin që ata të përkrahin shkollimin e lartë për gra. Komuniteti ngriti fondet dhe siguroi lejen për ndërtimin e shkollave në komunitetet e tyre, në mënyrë që vajzat dhe çunat të mos kenë nevojë të udhëtojnë aq gjatë për tu shkolluar. Marta në mënyrë sekrete i bartte fondet në Hasnga Diaspora



Marte Prenkpalaj morri çmimin ndërkombëtar për kreativitetin e grave në jetën rurale, në Prishtinë më 15 tetor.

Shqiptare në Kroaci duke ndërmarrë rreziqe personale, vetëm që komuniteti të mund të ndërtonte shkollën.

Sot në Has 50% të mësimit janë gra të cilat Motrat Qiriazit i ka përkrahur në vazhdimin e shkollimit të tyre. Të gjitha qendrat mjekësore në Has punësojnë gra dhe burra që janë shkolluar në Has. Siç thotë shpesh Marta, "Ditëve të sotme nuk diskutohet nëse vajzat duhet ta vazhdojnë shkollimin e mesëm, por si të gjenden mjetet për t'i përkrahur financiarisht ato që të vazhdojnë universitetin". Kur ushtria serbe pushtoi Krushën e Vogël, Marta me trimëri morri traktorin e saj dhe i barti gratë dhe fëmijët përtej lumit në një pjesë të sigurt. Gjatë qëndrimit në Shqipëri, ajo vazhdoi të përkrahë gratë dhe fëmijët që kishin pësuar trauma. Pas kthimit në Kosovë, Marta vazhdoi të përkrahë gratë nga Krusha të cilat kishin humbur anëtarët meshkuj të familjes së tyre, duke vajtuar me to, duke u ndihmuar në rindërtimin e komunitetit të tyre, duke i mësuar si të vozisin vetura e traktorë, dhe duke i mësuar si të jenë të vetë-përmbajtshme. Gjatë një dekade, Marta ka punuar me komunitetin e saj në

identifikimin e nevojave të tyre dhe në krijimin e klinikave lokale shëndetësore, trajnimin e ekspertëve mjekësor, ndërtimin e dy qendrave të komunitetit, ndërtimin e tri shkollave fillore, instalimin e gypave të ujit që lidhin fshatrat dhe furnizojnë me ujë të gjitha shtëpitë, hapjen e 11 bibliotekave lokale, asfaltimin e rrugëve, organizimin e garave ballkanike të vallëzimit, organizimin e sporteve të volejbollit dhe basketbollit për femra, dhe mësimin e shkrimit dhe leximit për qindra e qindra gra. Me përkushtimin, kreativitetin, dhe trimërinë e saj ajo ka udhëhequr komunitetin e saj drejt deklarimit : "Ne e bëmë këtë vetë!" Marta vazhdon të përfshijë qytetarët, ndonjëherë edhe qeverinë, në ngritjen e fondeve për nevojat e komunitetit. Kështu, Motrat Qiriazit është njëra ndër OJQ e pakta në Kosovë që nuk mbështetet në fondet ndërkombëtare, por më mirë merr përkrahje të plotë nga komuniteti i saj.

Aktivizmi i Marte Prenkpalaj është shembullor jo vetëm për OJQ-të në Kosovë, por për të gjitha aktivistet rurale e urbane anembanë botës. RrGK përgëzon Martën për çmimin e shumë-merituar që ajo morri.

Shënime nga Takimi i Nëntorit

Prioritetet për vitin 2007 që do të diskutohen në mbledhjen vjetore janë: anti-trafikimi, fuqizimi i gruas në politikë, pozitat vendimmarrëse dhe shëndeti i grave.

Zyra e Kryeministrit, ZQM informoi se është formuar grupi për raportimin e konventave ndërkombëtare dhe tani është duke raportuar për ekonomin, të drejtat sociale dhe kulturore. Grupi qeveritar për anti-trafikin, që përfshin dy përfaqësuese të shoqërisë civile, formuan grupe punuese për prandalimin e trafikimit dhe mbrojtjen e viktimave. ZQM gjithashtu formuan një komision për të drejtat e fëmijëve të udhëhequr nga Kryeministri Agim Çeku dhe 9 ministri tjerë. ZQM kërkon bashkëpunim me shoqërinë civile.

OJQ Kalabria tregoi se bashkëpunimi me KFOR dhe me Shërbimin Policor të Kosovës rezultoi me mbylljen e shtëpisë publike në afërsi të qendrës së tyre.

Qendra MVPT kërkoi maturi gjatë ndihmës viktimave të trafikimit.

OJQ Motrat Qiriazit ftoi anëtarët të cilat kanë gëshjtje të rëndësishme apo informata, të paraqiten në TV Opinioni në Prizren, ku Motrat Qiriazit tani ka programin mujor një-orësh, si dhe në ueb-faqen e TV Opinionit.

Shtëpia e Sigurtë tha që përmes projektit që kanë për parandalimin e trafikimit, ato kanë punuar me gratë nëpër fshatra dhe do të punojnë edhe me gratë nëpër qytete, mësuesit, e ndoshta edhe me ministrinë.

Agron Gashi nga UNICEF-i propozoi që OJQ të diskutojnë më shumë për shëndetin e grave.

Grupi i Veteranëve të Arsimimit tha që RrGK duhet të kërkojë që OJQ të lirohen nga TVSH-ja.

Pjesëmarrësit diskutuan për formimin e grupit për-krahës për anti-trafikim.

Lobi Rajonal i Grave Avokojnë në Vjenë

Gratë politikane dhe përfaqësueset e shoqërisë civile nga Evropa Jug Lindore u mblodhën më 9-10 shtator në Vjenë për takimin mbi "Proceset e Bisedimeve dhe tutje: Gratë për Paqe të Qëndrueshme në Evropën Jug Lindore".

Gratë nga Bosnja and Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Shqipëria dhe Kosova u takuan që të krijojnë strategji se si ato mund të shtojnë dukshmërinë dhe ndikimin e kontributit të grave drejt sigurimit të një zgjedhjeje paqësore dhe të zbatueshme për të zgjidhur konfliktin politik në rajon. Gratë analizuan dhe vlerësuan kontributin e grave në të kaluarën dhe potencialin e tyre akoma të pashfrytëzuar për avancimin e drejtësisë dhe pajtimit. Gratë konkluduan se pjesëmarrja e tyre në proceset politike ishte vendimtar për arritjen e paqes së qëndrueshme në rajon.

Pas punëtorisë, disa nga pjesëmarrëset u takuan me të Deleguarin Special për procesin e statusit të ardhshëm të



Lobi Rajonal i Grave u takua me të Deleguarin Special për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës, z. Martti Ahtisaari për të avokuar për implementimin e Rezolutës 1325.

Kosovës, z. Martti Ahtisaari dhe i'a paraqitën deklaratën e grupit mbi procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës. Deklarata kërkonte implementim të plotë të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, që bënë thirrje për sigurimin e përfshirjes së grave në të gjitha nivelet vendimmarrëse. Për herë të parë gratë nga rajoni u

pajtuan publikisht për vetëvendosjen e qytetarëve të Kosovës. Këshillimin rajonal e përkrahu United Nations Development Fund for Women (UNIFEM) (Zyra për Evropën Qendrore dhe Lindore). Punëtorja u përkrahu nga Komisioni Kombëtar i Austrisë për UNIFEM-in dhe Bruno Kriesky, Forumi për Bashkëbisedimet Ndërkombëtare.

Bluza e Fushatës të vitit 2000 "Kundër Dhunës Kundër Grave" Shëtit rreth Evropës



Derisa ishte në Vjenë, Drejtorja Ekzekutive e RrGK, Igballe Rogova, në rrugë takoi një burrë që po mbante bluzën me llogon e fushatës së RrGK "Burrat Kundër Dhunës Ndaj Grave", 2 0 0 0 .

Marsei ishte nga Franca dhe bluzën e kishte blerë në Poloni dhe tani po e mbante atë në Vjenë. Ai kurrë nuk kishte dëgjuar për fushatën në Kosovë, por ai po shpërndante mesazhin "Burrat Kundër Dhunës Ndaj Grave".

Gratë Shfaqin Mallërat në Ditët e Trashëgimis Kulturore

Më 16-20 shtator, u mbajt në Prishtinë "Ditët Evropiane të Trashëgimis Kulturore - Artizanatet ballkanike - Kosova". Zejtarët ekspozuan zejjet e punuara nga druri, sana, qeramika, thurrje, vizatime, skulptura, filigranet, litari, veshjet kombëtare të punuara nga gratë (Kosovare, Serbe, Rome, Ashkali, Gorane, Egjiptase), si dhe kullat të punuara miniaturë, të cilat kanë luajtur rol të rëndësishëm në trashëgimin kulturore kosovare. Dera e Hapur këtë vit bashkëpunoi me SHE ERA-n, Shoqata e Grave të Biznesit, për ta organizuar këtë manifestim.

Ekspozita dhe panairi u ndoq nga shumë visitor lokal dhe ndërkombëtar duke përfshirë këtu edhe shumë përfaqësues nga Sh.B.A., Zvicrra, Greqia dhe Zyra Britaneze, gjithashtu morrën pjesë zyrtar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë si dhe Ministria e Kulturës, Rinis dhe Sporteve.

Drejtori i Muzeut të Kosovës



Dy gra qepin dhe sheshin prodhimet e tyre në "Ditët e Trashëgimis Kulturore - Artizanatet Ballkanike - Kosovë" në Prishtinë më 16-20 shtator.

tregoi interesim që disa nga zejjet të ekspozohen në Muzeun Emingjik në Prishtinë. Në këtë manifestim ishin të pranishëm edhe përfaqësues të Komunave të Prishtinës, Gjakovës, Pejës, Mitrovicës, Gjilanit dhe komunave tjera.

Studentët të shumë e përcol-

lën panairin, e sidomos studentët nga Prishtina dhe studentët nga shkolla e mesme e tekstit në Gjilan u shprehën që në një të ardhme të afërt ata planifikojnë të bëjnë zeje të tilla.

Gjatë diskutimeve më organizatorët, pjesëmarrëset treguan interesimin e tyre të madh për të vazhduar ndihmën teknike si trajnimet, këshillat, dizajne për zeje të reja, si dhe promovimin e prodhimeve të tyre.

Ky manifestim u përcoll nga RTV21, BBC, Kosova Live, revista FOKUS, Koha Ditore, Bota Sot, Zëri, dhe Express.

Transmetimi i RTV21 në Evropë dhe Sh.B.A e drejtoi SHE ERA-n të krijoj kontakte me tregtar të interesuar për shitjen e këtyre prodhimeve në tregun e Sh.B.A.



"Çiftelija," instrument tradicional shqipëtar, në shitje gjatë panairit.

Gratë Prezantuan Punëdoret në Panairin e Artizanateve

Në Shkodër, në qytetin e lashtë nën kalanë e Rozafës u mbajtë panairi i artizanateve ku u prezantuan me veshje e punime dore gra nga rrethina e Shkodrës, Ulqinit dhe Kosovës. Organizuar nga shoqata "Gruaja Intelektuale Shkodrane" me rastin e hapjes kryetarja e kësaj shoqate Zejnepe Dibra tha se "ne jemi të një trungu prandaj edhe veshjet edhe punimet e dorës, edhe traditat e gatimit i kemi të njejta, dallo-

hemi vetëm nga nyansa, nga krahinat që prezantojmë".

Kosova u prezantua me punëdoret e regjionit të Pejës, Deçanit, Hasit e Gollakut.

Kryetarja e shoqatës "Dera e Hapur" Beti Muharremi duke falenderuar shkodranet për ftesë tha se është hera e parë pas luftës që Kosova të marr pjesë në një panair artizanatesh dhe në këtë laryshi punimesh ne sjellim këtu vetëm një pjesë të saj sepse

gratë kosovare janë të njohura për punimet tradicionale në vek dhe thurje, duke punuar kështu ato janë mbajtëse të familjes.

Gjatë panairit u mbajtën aktivitete artistike, Safete Rogova me veshjet e Hasit deklamoi vargje të poetëve, ndërkaq grupi i të rinjëve luajti valle të rrethinës së Shkodrës, si dhe u dëgjuan edhe këngë të Ulqinit me rrethinë.

Shënime nga Takimi i Shtatorit

Takimi filloi duke ndarë emocionet pas konferencës së Koalicionit të Grave për Paqe në Strugë, "Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara - Gratë, Paqja dhe Siguria", si dhe diskutuan për rezultatet e kësaj konference.

RrGK njoftoi për vizitat e bëra tek anëtarët për të diskutuar dhe nënshkruar Kodin mbi Etikën dhe Përgjegjësitë.

Së shpejti do të publikohet fletëpalosja e anëtareve të RrGK.

Qendra e Gruas "Ato" deklaroi se pas një kohë që organizata ishte jashtë funksionit, ato kanë rifilluar punën, edhe pse pa ndihmë të donatorëve.

Qendra Kosovare për Studime Gjinore njoftoi se Universiteti i Prishtinës gjatë këtyre ditëve pranoi rregulloren kundër ngacmimeve seksuale.

Qendra për Mirëqenien e Gruas nga Peja nënshkruan kontratën me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale që ministria të financojë strehimoren, por qendra akoma nuk i ka marr parat.

Zyra për Qeverisje të Mirë njoftoi se janë duke e organizuar një konferencë në tetor për integrimin e popullsisë Rome në shoqërinë kosovare. Ata kërkuar prej anëtareve që punojnë në këtë drejtim të marrin pjesë në konferencë.

Karl Kulesa nga United Nations Population Fund (UNFPA) informoi anëtarët lidhur me takimet në mes të agjencisë së Kombeve të Bashkuara dhe shoqërisë civile për bashkëpunim në të ardhmen.

Rrjeti i Grave të Kosovës

www.womensnetwork.org

info@womensnetwork.org

Hajdar Dushi C-2, II/8

Prishtinë, Kosovë

Stafi i RrGK

Igballe Rogova

Drejtoresha Ekzekutive
igorogova@yahoo.com

Nexhmije Fetahu

Menaxhere e Programit
cuca_fetahu@yahoo.com

Besa Shehu

Menaxhere e Financave
besa_shehu@yahoo.com

Alba Loxha

Marrëdhëniet me Publikun
albaloxha@yahoo.com

Bordi i RrGK

Naxhije Buçinca
Delina Fico

Besim Kajtazi

Marte Prenkpalaj

Vjosa Dobruna

Belgjyza Muharremi

Behar Selimi

"Zëri i Gruas Kosovare" është shkruar dhe dizajnuar nga Alba Loxha, me ndihmën e Nicole Farnsworth.

www.womensnetwork.org

Fondi Global për Gratë Takohet me RrGK

Më 10 tetor RrGK organizoi një takim me Global Fund for Women (GFW) në Hotel Prishtina.

Gjatë takimit, Angelika Arutyunova-Needham, Menaxhere e Programit për Evropë dhe Ish-Shtetet Sovjetike, në Global Fund for Women, prezantoi fondin dhe prioritetet e tij.

Global Fund for Women (GFW) është një fondacion jo-fitimprurës që ofron ndihmë financiare për ngritjen e të drejtave të grave nëpër gjithë botën.

Ata janë një rrjet i përbërë nga burra dhe gra që besojnë në atë se duke u siguruar grave një barazi dhe pjesëmarrje të plotë në shoqëri është mënyra më efektive që të ndërtohet një botë e drejtë, paqësore dhe e qëndrueshme.

Ata rrisin fondet nga burime të ndryshme dhe ndihmojnë financiarisht organizatat e udhëhequra nga gratë që promovojnë mbojtjen ekonomike, shëndetin, sigurinë, edukimin dhe udhëheqjen e grave dhe vajzave.

GFW është prezente në 120



Angelika Arutyunova-Needham, Menaxhere e Programit për Evropë dhe Ish-Shtetet Sovjetike, në Global Fund for Women, prezantoi fondin dhe prioritetet e tij në takimin me anëtarët e RrGK, në Prishtinë më 10 tetor.

shtete të botës. Ata përkrahin grupet e grave që punojnë së bashku, organizatat që demonstrojnë një përkushtim të plotë për barazin e grave dhe të drejtat e grave, organizatat që janë të udhëhequra dhe të qeverisura nga gratë, si dhe organizatat që janë të vendosura jashtë Shteteve të Bashkuara.

Pas prezentimit të GFW, anëtarët e RrGK diskutuan për

interesat dhe problemet me të cilat ato ballafaqohen nëpër komunitetet ku ato veprojnë.

Arutyunova-Needham u shpreh se ishte një takim shumë i frytshëm si dhe inkurajoi anëtarët që të dërgonin projektet e tyre në GFW.

Për më shumë informata se si të aplikoni për grante në GFW klikoni www.globalfundforwomen.org.

RrGK Ndanë Përvojat në Takimin me Gratë nga Baska në Spanjë

Më 23-24 tetor, Luljeta Vuniqi përfaqësoi RrGK në Takimin Ndërkombëtar SARE (Rrjeti i Grave në Baskë), të quajtur "Gratë Prodhojnë Paqen", organizuar nga Instituti i Grave Baske (Emakunde) në San Sebastián, Spanjë.

Organizata e formuar nga Parlamenti i Baskës dhe i përkrahur nga Presidenca e Qeverisë së Baskës, Emakunde, punon për përkrahjen e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në të gjitha sferat. Emakunde organizon Takimin Ndërkombëtar Vjetor SARE me qëllim që të diskutohet për mundësitë e barabarta për gratë dhe burrat, të vlerësohet puna e grave aktiviste si dhe për krijimin e rrjetëzimeve të reja.

Këtë vit organizatorët kërkuan të shtjellojnë rolin e grave në proceset paqësore, posaçërisht mundësitë e pjesëmarrjes së grave të Baskës në krahinë duke shoqëruar lajmërimin e armë-pushimit permanent nga Basque Homeland and Freedom (Euskadi Ta Askatasuna - ETA).

Duke mësuar përvojat në situata konfliktesh dhe negociata për paqe, nga gratë tjera aktiviste, ato shpresuan të "ndriçojnë" procesin paqësor të tyre, u shprehën organizatorët.

Gjatë këtij takimi, Vuniqi foli mbi "Gratë Ndërtojnë Koalicione" duke marrë si shembull lëvizjen e grave në Kosovë si dhe Koalicionin Paqësor të Grave të formuar së voni.

Koalicioni Paqësor i Grave që bashkoi gratë aktiviste nga Kosova dhe Serbia, është shembull se si gratë i mënjanojnë kufijtë dhe avokojnë për pjesëmarrjen e grave në procesin e paqes dhe programe tjera politike të përbashkëta.

Përveç programit zyrtar, Luljeta Vuniqi, Stasa Zajevec nga Gratë në të Zeza nga Beogradi dhe dia përfaqësuese nga Izraeli u takuan me një grup pralamentar për të drejtat e njeriut në Parlamentin Vitoria.

Për më shumë informata për SARE, klikoni:
www.sare-emakunde.com.

Për më shumë informata për Emakunde klikoni:
www.emakunde.es.